



FASILITETET, BURIMET MATERIALE, LOGJISTIKA DHE SHËRBIME TË TJERA

Krahas faktorëve të tjerë, një rol jo pak të rëndësishëm në përmbushjen e vizionit, misionit, dhe objektivave të Universitetit kanë edhe fasilitetet, burimet materiale, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj studentit .

Universiteti Jopublik “S&P Qiriazhi” ndodhet në Kodër Kamëz, brenda kampusit studentor të Universitetit Bujqësor të Tiranës. Godina tre katëshe e Universitetit ndodhet në një pozicion tepër të favorshëm për të realizuar me efektivitet të lartë të gjitha veprimtaritë edukuese, mësimore, shkencore dhe sportive-argëtuese.

Ai ndodhet larg zhurmave, larg qendrave industriale në një ambient të gjelbëruar. Mjediset e brendëshme janë moderne me hapësira tepër funksionale për zhvillimin e të gjitha veprimtarive universitare. Ato janë të pajisuara me pajisje didaktike të standarteve ndërkombëtare. Në ambientet e Universitetit (Fakultetit) disponojme:

Salla të mëdha leksionesh

- Salla për seminare
- Ambjente zyrash oër stafin akademik, punonjësit ndihmës dhe ata mbështetës të pajisuara me të gjitha pajisjet e domosdoshme
- Sallë moderne kompjuterash, ku ofrohet shërbimi i internetit. i cili ofrohet “non stop” si për studentët ashtu edhe për stafin akademik dhe punonjësit ndihmës.
- Bibliotekën dhe sallën e leximit
- Laboratorin e gjuhëve të huaja
- Ambjente sportive të mbyllura dhe natyrore

Universiteti gjithashtu ofron për studentët edhe shërbime të tjera si:

- Mundësi akomodimi për të gjithë ata studentë që mund të vijnë nga rrethet e Shqipërisë, nga Kosova, Maqedonia, Mali Zi etj.
- Mundësi transporti të garantuar nga Tirana deri në Universitet dhe kthim
- Mundësi kreditimi të butë për studentët (në marrëveshje me Bankat)